

## FTESË PËR OFERTË

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) me qëllim të sigurimit të stafit , fton të gjitha kompanitë e sigurimit që të paraqesin ofertat e tyre për:

### **Sigurimin shëndetësore dhe aksidentit për stafin e saj (rreth 230) per vitin 2023**

#### **Oferta duhet te permbaj informacionin si ne vijim:**

- Shuma e primit (çmimit) mujor i sigurimit per një person, me TVSH të përfshirë,
- Shuma e përgjithshme e rimbursimit për një vitë të policës
- Specifikimi i shteteve për mbulimin me sigurim,
- Dëmshtëpërblimi për paaftësi të përhershme, si pasojë e aksidentit (paaftësia e përhershme) vlera kapitale per paaftësi të tërësishme dhe paaftësi të pjesërishtme ,
- Shuma/përqindja e kompenzimit për trajtim jashtëspitalor
- Shuma/përqindja e kompenzimit për trajtim spitalor
- Shuma dhe mbulueshmëria per trajtim dentar, maternitet, trajtim psikiatrik, trajtim i te degjuarit, trajtim optik, kujdesi preventiv,
- Shpenzimet e shërbimeve te autoambulances nga vendi i aksidentit deri ne spitalin e pare
- Transporti jashte territorit te Kosoves
- Procedura e rimbursimit te shpenzimeve mjekësore, (e preferueshme qe rimbursimet te behen direkt nga siguruuesi tek kryesi i shërbimit).
- Përfitimet për kompensimet ditorë në rast të paaftësisë së përkohshme, si pasojë e aksidentit (kompensimi ditor),
- Oferta poashtu duhet te saktësoj nëse për te gjithë te punësuarit ne vitin e pare te sigurimit do te aplikohen përjashtimet nga sigurimi për sëmundjet priekzistuese, kongjenitale, kronike, defektet apo deformacionet si rezultat i sëmundjeve apo aksidenteve ekzistuese para datës se sigurimit apo ky përjashtim nuk do te aplikohet.
- Detaje tjera lidhur me kushtet e sigurimit,

#### **Kompanitë e interesuara per ofertim duhet te paraqesin edhe:**

- Certifikaten e biznesit,
- Licencen për operim nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) për dhënien e shërbimeve të cekura më lartë,
- Referencat nga klientët paraprak.

Kontrata me ofertuesin e suksesshëm do te lidhet për periudhën Janar-Dhjetor 2023 me mundësi ripërtëritje.

Afati për paraqitjen e ofertave është deri me datën **14.11.2022** në adresën e më poshtme: **Kreditimi Rural i Kosovës LLC / Rr. Behije Dashi, Nr.20 / 10000 Prishtinë** apo përmes email adresës **krk\_imf@krk-ks.com**.